



Republika e Kosovës  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI  
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT  
NR. 08/2018**

11 tetor 2018

## I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt rregulloren e AAC-së, si në vijim:

### **Rregullore nr. 08/2018 për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, si dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra**

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 03 shtator deri më datë 18 shtator 2018.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: "AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar"

Në rastin e projekt rregullores se sipërpërmendur konsultimi publik u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

## II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Në thirrjen e dërguar për konsultim publik të palëve të interesit nuk janë paraqitur vërejtje/sugjerime në lidhje me rregulloren e cila ka të bëjë me specifikacionet shtesë për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, si dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra.

## III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt rregulloren nuk ka pasur asnjë koment nga palët e interesit dhe si rrjedhojë nuk ka nevojë për komentim shtesë nga ana e AAC-së. Rregullorja në fjalë plotëson kushtet për të hyrë në fuqi si e tillë.

**Raporti është hartuar nga:**

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve